

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: *Komuna e Podujevës*

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: *615-23-6339-I-1-1*

Sa i përket tenderit për: *Furnizim me material higjenik*

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

KIGA ShPK

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Fushë Kosovë

(Adresa)

12000

Fushë Kosovë

(Vendi)

(Kodi postar)

049333467

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Ismail Shabani

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

kigashpk@gmail.com

(Adresa elektronike)

15.04.2024

(Data e parashtrimit të ankesës)



(Nënshkrimi dhe vula)



*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës].

Furnizim me material higjenik

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin

108A te LPP-se.

Kërkesa për rishqyrtim është refuzuar si e pabazuar nga autoriteti kontraktues.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Ligji i Prokurimit Publik

- Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
- Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi
- Neni 57 - Sigurimi i Tenderit
- Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

I. HYRJE

1. Me datën 23.06.2023 nga ana e Autoritetit Kontraktues Komuna e Podujevës (tutje referuar si: "Autoriteti Kontraktues") është publikuar Njoftimi për Kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: "*Furnizim me material higjenik*".
2. Brenda afatit të parashikuar ligjor, ne si operator ekonomik KIGA ShPK (tutje referuar si: "Ankuesi") kemi dorëzuar ofertë duke i plotësuar të gjitha kriteret e dosjes së tenderit.
3. Me datën 10.11.2023 Autoriteti Kontraktues ka bërë publikimin e Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues me anë të të cilit ofertën e Ankuesit e ka shpallur fituese dhe ka rekomanduar për dhënie të kontratës.
4. Brenda afatit ligjor për shfrytëzimin e mjeteve juridike është dorëzuar kërkesë për rishqyrtim dhe më pas ankesë në Organin Shqyrtues të Prokurimit (tutje referuar si: "OSHP").

5. Me datën 07.03.2024, OSHP ka nxjerr vendimin OSHP:2023/0946 me anë të së cilës ka aprovuar pjesërisht ankesën dhe ka lënë në fuqi vendimin e Autoritetit Kontraktues.
6. Nga kjo datë, janë plotësuar të gjitha kushtet për nënshkrimin e kontratës me Ankuesin si operator i përgjegjshëm, pasi që nuk kishte asnjë arsye për hezitim apo rivlerësim nga autoriteti kontraktues.
7. Me datën 28.03.2024 kemi pranuar një Njoftim të ri mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues me anë të së cilit kemi mësuar se Autoriteti Kontraktues na ka eliminuar, me arsyetimin kinse nuk kemi bërë vazhdimin e validitetit të ofertave.
8. Ankuesi përmes Kërkesës për Rishqyrtim i ka sqaruar Autoritetit Kontraktues se me lënien në fuqi të vendimit të autoritetit kontraktues, Komuna e Podujevës duhet të bëjë nënshkrimin e kontratës dhe nuk ka të drejtë që lëndën ta kthejë në rivlerësim. Kjo pasi që faza e vlerësimit të ofertave përfundon, në momentin që OSHP e vërteton një njoftim të Autoritetit Kontraktues.
9. Sipas Rregullores së Prokurimit Publik neni 40 paragrafi 4 Autoriteti Kontraktues obligohet të veprojë si në vijim: *"Pas skadimit të afatit kohor për parashtrim dhe shqyrtim të ankesave në Njoftimin mbi Vendimin e AK(B58), Autoriteti Kontraktues obligohet të përgatit draftin e kontratës dhe nënshkruaj atë brenda 30 ditëve kalendarike."* Po ashtu sikurse e obligon edhe neni 24, paragrafi 2 i LPP *"Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj"*.
10. Kjo çështje administrative është e përfunduar, bazuar në nenin 10 të Ligjit të Prokurimit Publik lidhur me nenin 42 të Rregullores, prandaj Komuna e Podujevës nuk ka kompetencë që lëndën ta kthejë në rivlerësim apo të ndërmarrë veprime të tjera, përveç asaj të nënshkrimit të kontratës. Komuna në përputhje me pikën 2 të dispozitivit do të duhej të vepronte në përputhje me Vendimin e OSHP 2023/0946.
11. Në këtë vendim siç është theksuar edhe nga eksperti edhe nga paneli i OSHP ankuesi i plotëson të gjitha kushtet për tu shpallur fitues dhe për të nënshkruar kontratën me autoritetin kontraktues.
12. Për më tepër vet kërkesa për vazhdim të validitetit të ofertave, përkundër se të gjitha ofertave u kishte kaluar validiteti për shkak të pezullimit të lëndës në OSHP, tregon qasje selektive të autoritetit kontraktues dhe tendencë për ti bishtëruar vendimit të OSHP 2023/0946. Ankuesi si operator ekonomik vullnetarisht e ka zgjatur validitetin e ofertës me datë 21.11.2023 për 90 ditë nga data e skadimit të validitetit të ofertës e që ishte data 05.12.2023.
13. Ankuesi ishte i vetmi operator i cili nuk kishte pasur asnjë moment shkëputje të validitetit për gjatë gjithë fazës së vlerësimit të ofertave dhe pezullimit të procedurës si rezultat i ankesës. Arsyeja e mos zgjatjes së validitetit, qëndron në faktin se Ankuesi nuk është njoftuar fare nga Autoriteti Kontraktues për zgjatje të validitetit, pasi që dokumenti është ngarkuar tek *"Dokumentet shtojca"* dhe për rezultat ankuesi nuk ka pranuar asnjë njoftim se diçka e tillë është kërkuar nga Autoritetit Kontraktues.

14. Ankuesi përmes kërkesës për rishqyrtim i ka rikujtuar Autoritetit Kontraktues se moszbatimi i vendimit të OSHP-së është bazë për marrje të veprimeve nga OSHP, sipas Neni 131 [Shkeljet e Ligjit nga Autoriteti Kontraktues].

Prandaj, duke marrë në konsideratë të gjitha faktet dhe argumentet e theksuara më lartë, Ankuesi me respekt i kërkon Panelit Shqyrtues që të nxjerr këtë nxjerr këtë:

VENDIM

- I. **APROVOHET** si e bazuar Ankesa e operatorit ekonomik KIGA ShPK me adresë në Fushë Kosovë.
- II. **ANULOHET** Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues i datës 28.03.2024.
- III. **DETYROHET** autoriteti kontraktues Komuna e Podujevës që të vazhdoj procesin e prokurimit në bazë të vendimit të datës 10.11.2023, dhe të përgatis kontratën për nënshkrim në mes të palëve.
- IV. **I KTHEHEN** mjetet e deponuara në emër të tarifës për parashtrimin e ankesës në llogarinë e operatorit ekonomik KIGA ShPK.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përfundim me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përfundim me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, originalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*